



U R D H Ë R

Nr.43, datë 12.2.2019

PËR

CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Etjen Xhafaj, si koordinator shtetëror për ndjekjen e procesit të inicimit, negociimit dhe finalizimit të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, në zbatim të masës 23, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme autorizohet të zhvillojë bisedimet për iniciimin dhe negocimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.
3. Për këtë proces koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA